



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Kuvendi i Komunës Klinë
Komiteti për Politik dhe Financa
01Nr 06-15652 19
Klinë, 18.04 2019

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e III-te e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 20.03.2019, duke filluar me 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës Klinë

RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për vënie ne diskutim publik të Draft-rregullores për themelimin dhe strukturimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve,
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2018 në vitin 2019
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për trasenë e rrugës transit të Klinës,
6. Shqyrtimi në pako i Rekomandimeve të MAPL dhe Ministrit të linjës lidhur me:
 - Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale /dhjetor 2018,
 - Statutin e Qendrës për Punë Sociale dhjetor/2010, dhe
 - Vendimit-Planit të veprimit për transparencë në Komunën e Klinës 2019,
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e Këshillit Organizativ të Festivalit “I Këndojmë Lirisë” 2019,
8. Shqyrtimi i kërkesave të arritura në KPF për muajin shkurt dhe mars 2019

9. Të ndryshme.

Pjesëmarrës ishin anëtarët e Komitetit:

- 1-Fadil Gashi-Kryesues
- 2-Tunë Dedaj-anëtar
- 3-Vjoleta Zefi- “
- 4-Blerta Gashi- “
- 5-Enver Berisha- “
- 6-Mendehie Duraku - “
- 7-Xhevxhet Berisha – “

Mbledhjen e hapi z. Fadil Gashi, Kryesues i komitetit, i cili përshëndeti të gjithë të pranishmit, lexoj pikat e rendit të ditës, kërkoj nga anëtarët nëse kanë diçka rreth rendit të ditës.

Të gjithë ishin pro rendit të ditës,

1. Arsytimi i mungesave.

Të gjithë anëtarët e komitetit ishin prezent.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

U shqyrtua dhe u miratua procesverbali i seancës së kaluar.

3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për vënie në diskutim publik të Draft-rregullores për themelimin dhe strukturimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve.

Fadil Gashi, hapi debat rreth pikës së tretë, theksoj se kjo është një draft rregullore e cila duhet të diskutohet në Kuvend dhe prapë do të vijë për diskutim në KPF, nëse ka dikush diçka rreth kësaj pike urdhëroni!

Enver Berisha, përshëndeti të gjithë të pranishmit, theksoj se kohë më parë ka funksionuar Asambleja e fëmijëve, nuk e di a ka pasur apo jo ndonjë rregullore apo diçka të hartuar, është domosdoshmëri ta kem një asamble të fëmijëve që të jetë funksionale, ne nuk po hyjmë në detale, mendoj që duhet ta diskutojmë në asamble.

Fadil Gashi, tha se Asambleja e fëmijëve ka funksionuar edhe me herët, por nuk ka pasur ndonjë Draft-rregullore të hartuar, ne e kemi një draft - rregullore të cilën na e kanë dorëzuar, keni pas mundësi me pa edhe ju si anëtar kush është që kjo të kalojë në asamble për diskutim?

Të gjithë ishin për.

4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2018 në vitin 2019.

Fadil Gashi, tha se ju tashme e keni materialin por për ndonjë sqarim shtesë ia jap fjalën drejtorit Aziz Desku urdhëroni:

Aziz Desku, përshëndeti të gjithë të pranishmit, tha se është në proces që zhvillohet për çdo vit bëhet fjalë për mjetet që janë inkasuar në vitin 2018 dhe nuk janë shpenzuar gjatë vitit 2018 dhe janë bartur në vitin 2019, në kuadër të këtij propozim-vendimi jemi përpjekur me ruajtur strukturën e mjeteve sipas kategorive ekonomike, por me disa konsultime me kryetarin dhe me ministrin e financave kemi bërë disa ndryshime dhe një prej tyre me i rëndësishmi është nga mjetet e bartura për projekte kapitale shumë prej 20,026.00 kemi vendos me i orientuar në subvencione, sepse siç e dini edhe gjatë vitit të kaluar kur e kemi miratuar buxhetin kërkesa për subvencione në bujqësi ka qenë me e madhe mirëpo kriteret e atëhershme nuk na kanë lejuar, përndryshe kategoritë tjera të gjitha kanë mbetur të njëjta, ndërsa sa i përket projekteve kapitale edhe këtu është bërë një harmonizim p.sh aty ku ka qenë projekti më i vogël dhe kanë mbetur mjete të pashfrytëzueshme i kemi bartur aty ku ka qenë projekti më i madh dhe ka pasur mungesë të mjeteve, për shpenzime kapitale ka mjete të bartura në tërësi është shuma 235,071.40 € ju në këtë propozim-vendim i keni të gjitha, totali i mjeteve të bartura nga viti 2018 në vitin 2019 është shuma prej 298,998,53 ky është totali i përgjithshëm i shpërndarë nëpër kategori ekonomike nëse ka nevojë për ndonjë sqarim shtesë urdhëroni.

Enver Berisha, tha se me sa kam informata enda s'ka përfunduar projekti paraparak i varrezave të dëshmoreve dhe këtu po shihet që është prapë 21 mijë euro të ndara, kjo a është pjesë e re që është paraparë apo diçka tjetër?

Aziz Desku, tha se nuk bëhet fjalë për ndonjë projekt të ri kjo është nga projekti ekzistues nga viti i kaluar, por pagesa që është bërë nga viti i kaluar është vetëm 2600 euro nuk ka pasur ndonjë pagesë tjetër kështu që obligimet për këtë projekt janë kjo shumë që është në këtë propozim-vendim.

Enver Berisha, tha se kam biseduar edhe me Kryetarin për një kanal të ujitjes 200 metra shtesë në fshatin Dollovë një pjesë që është ndarë në 300, 300, 300, pra gjithsej 900 metra në pjesën kryesore të fshatit kam kërkuar të shtohen edhe 200 e kam marrë konfirmimin nga Kryetari, por nuk e di nuk qenkan të parapara apo ndoshta ka menduar të jetë prej ndonjë fondi tjetër shtesë.

Aziz Desku, tha se këtu bëhet fjalë vetëm për projektet që kanë qenë gjatë vitit të kaluar dhe që janë në vazhdim që janë të papërfunduara, propozim i yt besoj që do të hyjë në kuadër të projekteve të vitit 2019.

Tunë Dedaj, përshëndeti të gjithë të pranishmit, tha se po e shoh se vitin e kaluar kanë mbetur shumë mjete të pa shpenzuara e të cilat janë bartur për vitin 2019, është mirë që këtë vit të kemi kujdes dhe t'i hapim tenderët me kohë, të bëhen pagesat me kohë, sepse nuk kemi buxhet të madh ne si komunë që të mos shpenzohen, por duhet të jemi më të përkushtuar, edhe unë pajtohem që këto mjete të barten ashtu siç janë paraparë.

Aziz Desku, tha se kjo që e tha Tuna është mirë duhet të kemi kujdes dhe përkushtim që shuma e mbetjeve të jetë sa më e vogël, por duke marrë parasysh që një pjesë e mjeteve inkasohen deri në ditën e fundit të vitit prej të hyrave vetanake nuk është e mundur të shfrytëzohen në tërësi, shuma prej 100 mijë euro kanë qenë të hyra vetanake gjatë muajit dhjetor.

Tunë Dedaj, theksoi se aty kanë mbetur 300 mijë euro nga viti i kaluar nuk janë 100 mijë dhe duhet kushtuar kujdes që të shpenzohen me kohë, duhet marrë masa ndaj atyre kompanive të cilat nuk kanë kryer punët me kohë dhe të ndëshkohen.

Lorenc Marleku, tha se ne kemi marrë masa sa i përket drejtorisë time janë tri kompani të cilat nuk kanë të drejtë të marrin punë janë të eliminuara njëres edhe ia kemi marrë tenderin dhe janë disa tjera që kanë marrë edhe vërejtjen e fundit, ne kur kemi ardhur në pushtet s'kemi parë asnjë kompani që është ndëshkuar.

Tunë Dedaj, tha se me vjen shumë mirë që keni marrë masa, por jo vetëm masa por ato kompani duhet përjashtuar dhe të mos u jepet punë fare, në këtë vit duhet shikuar dhe të merren masat sa më herët dhe të mos iu bëhet pagesat, p.sh: tek varrezat e dëshmoreve aty nuk është dashtë as t'i pranohet puna, sepse nuk është kryer puna me rregull dhe nuk është dashtë t'i paguhen mjete fare.

Lorenc Marleku, theksoi se tek varrezat e dëshmoreve kanë qenë dy ofertues, ne i kemi pasur të ndara 50 mijë euro ofertuesi i parë ka qenë 20 mijë euro, ndërsa ofertuesi i dytë ka qenë 60 mijë euro, ne e kemi ditë nga fillimi që nuk do të mund ta kryejë punën, por është dashtë gjithsesi të ja japim, sepse kështu e parashih ligji që ofertuesi më i lirë e fiton tenderin, mangësia e prokurimit në na ka dëmtuar shumë dhe duhet të ndryshohet Ligji i prokurimit nuk është faji i jonë.

Tunë Dedaj, tha unë mendoj se kur iu e parashihni se ai nuk mundë ta kryejë punën si p.sh. tek varrezat e dëshmoreve me 20 mijë euro në këtë rast nuk duhet t'i jepet as puna fare, kam informata se është jep tenderi për furnizim me zhavorr 0.80 cent kubiku nuk duhet jep tenderi në këtë rast, sepse nuk mund të kryejë furnizimin me këtë çmim.

Fadil Gashi, tha se duhet respektuar ligji, sepse ata po e dërgojnë lëndën në OSHP dhe OSHP-ja e kthen e kështu me radhë, kush është që shqyrtimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2018 në vitin 2019 të rekomandohet për kuvend? Të gjithë ishin për.

5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për trasenë e rrugës transit të Klinës.

Fadil Gashi, tha se materialin e keni para dhe mund ta shikoni se ne cilën pjesë do të rregullohet rruga e transitit kjo është traseja ne duhet që ta rekomandojmë për kuvend, kuvendi ta votojë dhe të fillohet me implementimin e dokumentit konceptual edhe i projektit e pastaj edhe fillimi i punimeve, nëse ka dikush diçka rreth kësaj pike urdhëroni, të gjithë ishin të pajtimit që kjo pikë e rendit të ditës të rekomandohet për kuvend.

Me vota unanime u rekomandua për kuvend.

6. Shqyrtimi në pako i Rekomandimeve të MAPL dhe ministrit e linjës lidhur me:

- Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale /dhjetor 2018,
- Statutin e Qendrës për Punë Sociale dhjetor/2010, dhe
- Vendimit-planit të veprimit për transparencë në Komunën e Klinës 2019.

Fadil Gashi, për vendimin e Planit të veprimit për transparencë ne e kemi bërë për një vit, kurse ata –MAPL, e kanë kërkuar nga ne që plani për transparencë të jetë për katër vite, ne deri në këtë vit e kemi bërë për një vit edhe më parë është bërë për një vit, por kanë kërkuar nga ne dhe duhet ta ndryshojmë.

Enver Berisha, tha se ne jemi dakorduar që secila drejtori veç e veç të bëjë ndryshimet e kërkuara edhe i pash qe ato ndryshime veç janë bërë, mendoj se nuk kemi nevojë të debatojmë.

Ajet Sejdiu, tha, lidhur me rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, unë mendoj se të gjitha ndryshimet që janë bërë veç i keni marrë, por është një ndryshim të cilin e ka propozuar kryetari dhe drejtorja e shërbimeve publike tek neni 42 i Rregullores për taksa tek pika 1.16 të shtohet edhe një tarifë për pronën komunale qe merret me qira për kohën një vjeçare, të cilat janë te rrethuara me plastik apo qelq t'i dyfishohet taksa nga 10 euro metra katrorë sa ka qenë të bëhet 20 euro.

Fadil Gashi, tha ne e kemi këtë kërkesë, nëse nuk është dikush kundër ne mund ta rekomandojmë për kuvend, e hodhi në votim dhe të gjithë ishin pro.

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e këshillit organizativ të festivalit “I këndojmë lirisë” 2019.

Fadil Gashi, tha unë kam një kërkesë që është bërë nga drejtorja janë edhe emrat e këshillit organizativ, nëse ka dikush diçka rreth kësaj pike urdhëroni, nëse nuk ka kush është për që kjo të rekomandohet për kuvend, të gjithë ishin për.

8. Shqyrtimi i kërkesave të arritura në KPF për muajin shkurt dhe mars 2019.

Fadil Gashi, tha se kërkesë tjetër është nga zyra e kryetarit për definimin e shumës për shpenzimet e varrimit për qytetaret e Komunës se Klinës Zyra e Kryetarit ka propozuar që shuma të jetë 170 euro, afati i paraparë për aplikim për kompensimin e këtyre mjeteve është 30 ditë nga dita e vdekjes

janë të caktuara edhe cilat dokumente duhet plotësuar, mjetet të cilat do të paguhen janë nga subvencionet dhe transferet.

Enver Berisha, tha se kjo është një çështje cila është zvarritur më shumë sesa është dashtë, ka qenë mirë ta diskutojmë edhe me udhëheqësit fetarë me marr një mendim edhe nga ta për shumën e shpenzimeve për shpenzimet e varrimeve ndoshta është dashtë që të shtohet pak kjo shumë në asamble e kemi biseduar edhe më herët dhe kemi propozuar shumën prej 200 euro mendoj që kishte qen mirë, por pa marrë parasysh shumën mendoj se duhet të zbatohet posa të merret vendimi.

Fadil Gashi, tha ne mund të diskutojmë edhe në kuvend për shumën por është e komunikuar që kjo shumë i mbulon shpenzimet e varrimit që qytetaret duhet paguar, por mund të kërkojmë edhe në kuvend kur të merret vendimi që kjo të vijë në zbatim menjëherë.

Tunë Dedaj, tha, ne kemi dëshirë jo vetëm 170 apo 200 por edhe më shumë t'i ndihmojmë, por me siguri edhe kryetari në bazë të mundësive buxhetore të parapara ka paraparë këtë shumë, por e rëndësishme është sepse është marr iniciativë që t'u kompensohen këto shpenzime të varrimit.

Skender Veseli, tha mendoj që është iniciativë e mirë mendoj se ka qenë mirë që në kuadër të atyre dokumentacioneve të kërkohet edhe certifikata e vdekjes.

Fadil Gashi, tha se edhe certifikata e vdekjes kërkohet dhe është një nga kushtet që duhet plotësuar, nga aplikuesit të cilët kërkojnë që të kompensohen.

Aziz Desku, theksoi se rreth shumës kisha kërkuar që mos të ketë ndonjë ngritje të kësaj shume, sepse ne kështu e kemi përlllogaritur dhe çdo ndryshim do të na sillte vështirësi në zbatim të këtij propozimi, në të ardhmen nëse kemi mundësi buxhetore mund edhe të ngritët.

Fadil Gashi, tha nëse ju pajtoheni e rekomandojmë për kuvend, kush është për?

Të gjithë anëtarët votuan për.

Kërkesa e dytë, kërkesë nga **banorët e lagjes Drini i Bardhë**, të cilët kërkojnë që mos të jepen leje për ndërtim të lart në pjesën e mbetur pa u ndërtuar, ne po e shqyrtojmë këtë kërkesë, por ka qenë mirë që t'i jepet Drejtorisë së Urbanizmit dhe ta shikojë se si është e rregulluar me plan urbanistik nëse është e ndaluar nuk mund te jepet leje, sepse ne nuk mund të marrim ndonjë vendim, unë po hapi debat rreth kësaj,

Enver Berisha, tha si do që të jetë Drejtoria e Urbanizmit të na jep ndonjë sqarim në seancë.

Fadil Gashi, tha, unë kam qenë në dilemë se si ta trajtoj këtë lëndë si kërkesë apo si peticion, sepse ka edhe shumë nënshkrime, por titullin e ka kërkesë dhe kam qenë në mëdyshje se si ta trajtoj si kërkesë apo si peticion, me qenë peticion ne duhet ta dërgojmë drejt në seancë kemi afatin ligjor që duhet ta shqyrtojmë, por nëse pajtoheni edhe ju ne po kërkojmë nga drejtoria që ta shqyrtojë këtë kërkesë dhe le të merret se si e sheh për atë zonë plani zhvillimor urban dhe plani rregullativ detal, por janë duke u punuar edhe hartat zonale duhet respektuar vullneti i qytetarëve, por se pari duhet respektuar plani urbanistik i qytetit, nëse edhe ju pajtoheni kështu. Kush është për?

Të gjithë ishin për.

Kërkesa e tretë është nga **Vitor Gjioda, nga Klina**, dhe njëherit punëtor i Administratës Komunale të Klinës duke filluar nga viti 1977 dhe vazhdoi të punojë që nga paslufta nga viti 1999 e deri me sot, pasi që jam i sëmur dhe i diagnostifikuar me një sëmundje të rënd dhe më është dashur t'i nënshtrohem edhe një operimi, i cili me ka kushtuar mjaft shumë kërkoj nga që të me ndihmoni brenda mundësive buxhetore nga buxheti i Komunës.

Ne Vitorin e njohim të gjithë kam biseduar edhe me Kryetarin ne kemi dëshirë të gjithë ta ndihmojmë, por këtë kërkesë po e adresojmë tek Zyra e Kryetarit dhe kabineti i tij të merret me këtë kërkesë dhe brenda limiteve sa e ka të lejuar mund ta ndihmojë.

Tunë Dedaj, tha, ne jemi të gjithë që ta ndihmojmë, por ka qenë mirë që ta adresojmë tek Zyra e Kryetarit dhe brenda limiteve të lejuara ta ndihmojë.

Fadil Gashi, tha, unë pajtohem që ta adresojmë tek Zyra e Kryetarit, kush është për?

Të gjithë anëtarët votuan për.

Kërkesa tjetër është nga **Muharrem Kastrati nga Zajmi**, edhe ky kërkon që brenda mundësive buxhetore ta ndihmojmë, por nëse dhe ju pajtoheni po e adresojmë tek Zyra e Kryetarit dhe ai ka të paraparë shumën dhe limitet se sa mund të ndihmojë, kush është për?

Të gjithë anëtarët votuan për.

Kërkesë tjetër është nga **Besa Shala nga Klina**, kërkon që t'i jepet në shfrytëzim për kullosë të dhive dhe deleve pjesa e zonës kadastrale në Dresnik, është ligji i cili i përcakton dhënien në shfrytëzim të pronës fillimisht ne nuk kemi informacion a është pronë e jona apo e agjencionit pyjor. Nëse ju pajtoheni ne po e adresojmë edhe këtë kërkesë tek Zyra e Kryetarit, sepse ai paraprakisht ka një procedurë tjetër duhet ta shpall listën publike interesin se ku shpallën ato zona, ju e dini se në seancën e fundit në parlament ka ndryshuar edhe ligji për dhënie në shfrytëzim të këtyre hapësirave të presim edhe ligjin e ri i cili do të na ndihmojë edhe të merret një vendim, kush është ashtu siç e potencuam bashkërisht?

Të gjithë ishin për.

Nëse nuk ka dikush diçka tjetër, unë e kisha mbyllur këtë mbledhje.

Ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje!

Mbledhja përfundoi në ora 10:45.

Procesmbajtësi,

Ahmet Berisha

